



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

RREGULLORE
PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E MENAXHIMIT DHE
SHFRYTËZIMIT TË OBJEKTEVE SPORTIVE PUBLIKE
DHE FUSHAVE TË HAPURA PUBLIKE

Lipjan 2019

Në mbështetje të neneve 12 par.12.2 pika c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, , neneve 11 dhe 55 ,56 dhe 58 të Ligjit nr.2003/24 për Sportin, Ligjit nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/24 për Sport, neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 31. 01. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E MENAXHIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË OBJEKTEVE SPORTIVE PUBLIKE DHE FUSHAVE TË HAPURA PUBLIKE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e mënyrës së menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve sportive publike dhe fushave të hapura publike, përjashtimisht objekteve sportive shkollore dhe fushave sportive shkollore.

Neni 2

Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore definohe dhe rregullohen çështjet si vijon:

- a.) Menaxhimi i objekteve sportive publike;
- b.) Menaxhimi me fushat e hapura publike;
- c.) Funkcionet e objekteve sportive publike;
- d.) Të drejtën e shfrytëzimit të objekteve sportive publike;
- e.) Të hyrat e realizuara nga shfrytëzimi i objekteve sportive publike
- f.) Procedurat për marrjen në shfrytëzim të objekteve publike;
- g.) E drejta e reklamimit;
- h.) Lokalet në objektet sportive publike;
- i.) Rendi shtëpiak në objektet sportive publike
- j.) Orari
- k.) Miëmbajtja e objekteve sportive publike
- l.) Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara në objektet sportive-publike dhe
- m.) Masat ndëshkuese

Neni 3

Përkufizimet

1. "DKRS" nënkupton Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. "Objekti Sportiv Publik" nënkupton objektin brenda dhe jashtë.

3. "Udhëheqësi i objektit sportiv publik" nënkupton personin zyrtar që kujdeset për planifikim dhe organizim të punëve , koordinimin me klubet, komunikimin me strukturat e Komunës, kontrollin e stafit, raportimin e punës.
4. "Aktivitet Sportiv" nënkupton të gjitha organizimet nga personat fizik dhe juridik për zhvillimin e veprimtarive garuese-rekreative.
5. "Aktivitete jo-sportive" nënkupton të gjitha organizimet nga personat fizik dhe juridik për zhvillimin e aktiviteteve josportive.

Neni 4

Menaxhimi i objekteve sportive publike

1. Përgjegjës për menaxhimin e objekteve sportive-publike është Komuna e Lipjanit respektivisht Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Sektori i sportit në kuadër të DKRS-së.
2. Për organizimin e brendshëm strukturor vendos Kryetari i Komunës së Lipjanit, me rekomandim të Drejtoratit për Kulturë, Rinisë dhe Sport.
3. Zyrtarëve përgjegjës të objekteve publike nuk u lejohet pa vendimin e organeve përgjegjëse komunale të bëjnë asnjë ndryshim fizik në objektin sportiv.

Neni 5

Menaxhimi me fushat e hapura publike

1. Përgjegjës për menaxhimin e fushave të hapura publike është Komuna e Lipjanit respektivisht Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .
2. DKRS në kudër të detyrave dhe përgjegjësi është e obliguar që nëpërmjet zyrtareve të këtij Drejtorati në mënyrë të vazhdueshme të vizitojë dhe kontrollojë fushat e hapura publike dhe të mbajë procesverbal duke evidentuar gjendjen faktike si dhe parregullsitë apo dëmet eventuale.

Neni 6

Funksionet e objekteve sportive publike

1. Funksioni primar i objektit sportiv publik është realizimi i aktiviteteve sportive për shkollat e sporteve, shoqatat sportive, lidhjet -klubet sportive si dhe organizatat që janë të regjistruara në organet përkatës e publike.
 2. Funksioni sekondari objektit sportiv publik është në funksion të ngjarejeve që nuk kanë karakter sportiv
- 2.1 Aktivitetet josportive bëhen me kërkesë të veçantë dhe vetëm ato aktivitete që nuk bien në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik.

Neni 7

E drejta e shfrytëzimit

1. Të drejtën e shfrytëzimit të objekteve sportive publike për aktivitetet sportive dhe josportive e kanë personat fizik dhe juridik.

2. Shfrytëzuesit e objekteve sportive publike për aktivitetet sportive parashtrojnë kërkesë dhe marrin leje -pëlqim nga organi përgjegjës i DKRS-së.

Neni 8

Të hyrat e relizuara nga shfrytëzimi i objekteve sportive publike

1. Të hyrat e realizura nga shfrytëzimi i objekteve sportive publike janë të hyra vetanake të Komunës dhe derdhen në xhirollogarinë e Komunës.
2. Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve sportive publike përcaktohen në Rregulloren për taksa komunale.
3. Nga pagesa e taksave për shfrytëzimin e përkohshëm të objektet sportive publike lirohen klubet e komunës të cilat janë të kualifikuara dhe garojnë në ligat përkatëse sportive.

Neni 9

Procedurat për shfrytëzimin e objekteve sportive publike

1. Për aktivitete sportive dhe josportive, secili person fizik dhe juridik duhet të paraqesë kërkesë me shkrim 48 orë para aktivitetit në organin kompetent përkatësisht në DKRS.
2. Të gjitha aktivitetet që organizohen nga DKRS-së dhe Komuna e Lipjanit, lirohen nga të gjitha obligimet, por që duhet të bëhet njoftimi.
3. Organizatat të cilat obligohen të bëjnë pagesa, duhet të marrin formularin e fletëpagesës në organin kompetent të DKRS-së.
4. Organizatat sportive dhe josportive duhet të paraqesin një kërkesë zyrtare, planin e punës, lejen e njoftimit të personit përgjegjës dhe çertifikatat e organizatës (regjistrimit dhe fiskal)

Neni 10

E drejta e reklamimit

1. Të gjitha palët e interesuara kanë të drejtë të reklamojnë logot e firmave të tyre.
2. Palët e interesuara për reklamim duhet të bëjnë marrëveshje me organin kompetent respektivisht DKRS-në.
3. Çmimorja e reklamave do të përcaktohet në Rregulloren për Taksa Komunale.
4. Pala e interesuar paraprakisht duhet të marrin Pëlqim për vendosjen e reklames nga organi kompetent i DKRS-së.
5. Mediat e shkruara dhe elektronike hyrjen në objekte sportive publike e kanë falas, përveq nëse DKRS apo Organizatat Sportive parashohin ndryshe.

Neni 11

Lokalet në objektet sportive

1. Lokalet në objektet sportive jepen në shfrytëzim për palët e interesuara sipas Ligjit në fuqi për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, nëse një gjë e tillë vlerësohet e favorshme për Komunën e Lipjanit.

Neni 12

Rendi shtëpiak

Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve sportive publike duhet të respektojnë kodin e mirësjelljes, të miratuar nga DKRS-ja

Neni 13

Orari

1. Objekti sportiv është në funksion 5 ditë në javë,
 2. Orari i rregullt i punës është nga dita e hënë deri të premten,
 3. Orari i punës për zyrtarët përgjegjës do të jetë ashtu siq përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe vendimeve nga DKRS-ja për organizimin e orarit.
 4. Oraret tjera që nuk janë paraparë me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të rezervohen me kërkesa të posaçme.
- Fushat e hapura sportive nëpër fshatra nga muaji qershor deri në muajin gusht do të jenenë në dispozicion të aktiviteteve sportive sipas orarit 08:00 deri në 23:00, ndersa nga muaji shtator deri në muajin maj sipas orarit 08:00 deri në 22:00.

Neni 14

Mirëmbajtja

1. Përgjegjësit e objekteve sportive publike obligohen të përgadisnin një paramasë dhe parallogari për çdo intervenim të planifikuar dhe të parashtrojnë si kërkesë në DKRS-së për vitin e ardhshëm.
2. Pjesa e intervenimeve të vogla do të bëhet nga operatorët e kontraktuar nga Komuna e Lipjanit.
3. DKRS e shqyrton kërkesën e parashtruar për intervenim në mirëmbajtje dhe të njëjtën e parasheh në buxhet.
4. Investimet kapitale të nevojshme në objektin sportiv realizohen nga buxheti i Komunës së Lipjanit.
5. Nevojat për investime përcaktohen nga DKRS dhe aprovohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 15

Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara

1. Përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara e bart organizata nikoqire e cila organizon aktivitetin.
2. Për dëmin e bërë nga organizata nikoqire, DKRS-krijon komisionin prej tre anëtarësh, njëri anëtar është nga nikoqiri dhe dy nga DKRS për vlerësimin e dëmit. Kryetari i komisionit caktohet nga DKRS-ja.

Neni 16
Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilat nuk e respektojnë rendin shtëpiak, oraret, merren masa ndëshkuese si:

1.1 Vërejtje me gojë,

1.2 Vërejtje me shkrim

1.3 Pezullim të zhvillimit të aktiviteteve për një kohë të caktuar 3, 6 ose 9 muaj.

1.4 Përjashtim të përhershëm nga zhvillimi i aktiviteteve dhe hapja e procedurave ligjore.

2. Për zbatimin e masave ndëshkuese formohet komisioni, i cili propozohet nga DKRS-ja me vendim të Kryetarit të Komunës.

Neni 17
Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. DKRS- pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje është e obliguar që me nga një kopje të saj ti paisë të gjitha palët që shfrytëzojnë objektin sportiv.

Neni 18
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

15Nr. 011-7235

Lipjan, më 31. 01. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

